



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 22.10.2018

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR
BASHKËPUNIMIN E ZBATIMIT TË LIGJIT, PËR VENDOSJEN E OFICERIT
NDËRLIDHËS TË EUROPOL-IT”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.10.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të EUROPOL-IT”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Alket Hyseni.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministri i Brendshëm z.Besfort Lamallari dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Nëpërmjet projektligjit të propozuar synohet ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it.

Marrëveshja është iniciuar nga Europol-i, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, nënshkruar, më 9 dhjetor 2013 dhe të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 28/2014. Kjo marrëveshje ka patur si qëllim vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mbështesë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republikën e Shqipërisë në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar në fushat e krimit, në veçanti përmes shkëmbimit të informacionit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë.

Bashkëpunimi mes Republikës së Shqipërisë dhe Europolit materializohet nëpërmjet fushave përkatëse, të parashikuara nga neni 4 i kësaj marrëveshje, dhe konkretisht: i) shkëmbimi i informacionit; ii) shëmbimin e njohurive të specialistëve; iii) raportet e përgjithshme të situatave; iv) rezultatet e analizës strategjike; v) dhënia e informacionit në lidhje me procedurat e hetimit penal; vi) dhënia e informacionit mbi metodat e parandalimit të krimit; vii) pjesëmarrja në aktivitete trainimi; viii) dhënia e konsulencës dhe mbështetjes për hetimet penale individuale.

Vendosja e oficerit ndërlidhës të Europol-it në vendin tonë, konkretisht në Zyrën Kombëtare të Europol-i pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, synon të sjellë mbështetje, bashkërendim të veprimeve dhe bashkëpunim në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar, si dhe lehtësim të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Europol-it dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Marrëveshja e paraqitur për ratifikim ka rregulluar ndërmjet të tjerave edhe statusin e oficerit ndërlidhës, ku parashikohet se Shqipëria, brenda territorit të saj do t'i japë zyrtarit ndërlidhës të Europol-it të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato të akorduara nga Shqipëria për shtetet anëtare, me gradë të krahasueshme të stafit të misioneve diplomatike të vendosura në Shqipëri. Sipas parashikimeve të bëra në këtë marrëveshje, EUROPOL do të jetë e përjashtuar nga të gjitha detyrimet doganore, ndalimet dhe kufizimet në importin e eksportin në lidhje me mallrat për përdorim zyrtar.

Marrëveshja njëkohësisht ka parashikuar çështjet administrative për vendosjen e zyrës së oficerit ndërlidhës në Shqipëri, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe përgjegjësi në rast konflikti.

Kjo marrëveshje është miratuar në parim me vendimin nr.403, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar nga palët në Korrik të vitit 2018.

Marrëveshja parashikohet të hyjë në fuqi në datën kur Republika e Shqipërisë njofton EUROPOL-in për përfundimin e procedurave të brendshme të ratifikimit.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se ky projektligj do të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimeve në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ALKET HYSENI

ULSI MANJA